

GRUPI PUNUES  
KNBE PËR  
KAPITULLIN 35



**TRASHËGIMIA KULTURORE  
DHE FETARE SERBE NË KOSOVË  
NGA ZONAT E VEÇANTA TË AHTISAARIT  
DERI NË STATUSIN PËRFUNDIMTAR**



FONDACIJA ZA OTVORENO DRUŠTVO, SRBIJA



Nacionalni konvent  
o Evropkoj uniji



**Botuesi**

Instituti për Zhvillim Ekonomik Territorial (InTER)

**Për botuesin**

Dragiša Mijačić

**Autoret**

Stefan Surlić  
dr Igor Novaković

**Viti**

2020

Ky publikim është bërë në kuadër të projektit „Konventa Kombëtare rreth Bashkimit Evropian 2019/2020, Grupi Punues për Kapitullin 35” i financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, Serbi. Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të Fondacionit për Shoqëri të Hapur, Serbi, Konventës Kombëtare rreth Bashkimit Evropian, e as të Institutit për Zhvillim Ekonomik Territorial.

# **Trashëgimia kulturore dhe fetare serbe në Kosovë nga zonat e veçanta të Ahtisaarit deri në statusin përfundimtar**

*Stefan Surlić  
dr Igor Novaković*

**Prill 2020**



## **PËRMBAJTJA**

<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	1
<b>HYRJE</b> .....	1
<b>ZBATIMI I PLANIT TË AHTISAARIT NDËRMJET PAVARËSISË SË MBIKËQYRUR DHE REALIZIMIT TË PAMBIKËQYRUR</b> .....	4
<b>TRASHËGIMIA FETARE DHE KULTURORE SERBE – KONTESTIMI I TË DREJTAVE NË STATUSIN E DHËNË</b> 7	
<b>KONTESTET KRYESORE TË KISHËS ORTODOKSE SERBE DHE AUTORITETEVE NË KOSOVË</b> .....	11
Manastiri i Deçanit.....	11
Novobërda.....	12
Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë në Prizren .....	13
Tempulli Krishti Shpëtimtar në Prishtinë.....	13
<b>E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE ÇËSHTJA E MBROJTJES SË VENDEVE TË SHENJTA</b> .....	15
<b>SHEMBUJT E ZGJIDHJEVE TERRITORIALE NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN E VENDEVE TË SHENJTA NË EVROPË</b> .....	16
Mali i Shenjtë (Mali Athos) .....	16
Qyteti i Vatikanit .....	18
Paralelet .....	20
<b>SHEMBUJT E ZGJIDHJEVE TERRITORIALE PËR NJËSITË MË TË VOGLA</b> .....	22
Enklavat.....	22
Eksterritorialiteti (si koncept territorial) dhe territori që është në pronësi të subjektit tjetër .....	23
Sovraniteti i dyfishtë– kondominium .....	24
<b>PËRFUNDIM – GAMA E REALIZIMIT TË KUADRIT NORMATIV PËR TRASHËGIMINË FETARE DHE KULTURORE SERBE NË KOSOVË</b> .....	26
<b>REKOMANDIMET</b> .....	28



## PËRMBLEDHJE

Në analizë identifikohen mekanizmat mbrojtës për trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë të definuara me Planin i Ahtisaarit si kornizë normative bazë. Autorët nisen nga pretendimi se statusi i trashëgimisë kulturore ka munguar në mënyrë të pajustificueshme nga dialogu i Brukselit, dhe se kjo temë, për shkak të ndjeshmërisë së identitetit, mund të orientojë qytetarët në mbështetje të një marrëveshje të mundshme përfundimtare ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Në pjesën e parë të analizës jepet një pasqyrë gjithëpërfshirëse e garancive ligjore dhe e përvojës së zbatimit të tyre, ajo merret në detaje me shembujt e keqpërdorimit dhe të mosrespektimit të kornizës normative të miratuar, me kritikën ndaj statusit “të veçantë” për trashëgiminë serbe, si dhe kontestet e hapura ndërmjet Kishës Ortodokse Serbe dhe autoriteteve në Kosovë. Në pjesën e dytë, teksti jep një pasqyrë krahasuese të statuseve speciale të vendeve të shenjta në Evropë. Meqenëse në publik shpesh flitet për statusin eksterritorial si model përfundimtar për trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe, analiza trajton modele të zgjidhjeve territoriale për njësi më të vogla në formë të enklavave/esklavave, ekstraterritorialitetit dhe kondominiumit.

**Fjalët kyçe:** trashëgimia fetare dhe kulturore serbe, plani i Ahtisaarit, zonat e veçanta mbrojtëse për manastiret, Vatikani, Mali Athos, enklavat/esklavat, eksterritorialiteti, kondominiumi.

## HYRJE

Deri më tani statusi i trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe nuk ka qenë temë e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Ekzistojnë të paktën tri arsye se pse nuk është biseduar për respektim të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të veçorive kulturore dhe fetare të popullit serb në Kosovë. E para është identiteti, dhe për këtë arsye është shumë e ndjeshme, pasi që nga ana serbe, trashëgimia kulturore shihet si *“djepi i identitetit kombëtar”*, ndërsa nga ana shqiptare si pjesë e *“trashëgimisë së përgjithshme historike dhe kulturore”* të shtetit të porsa-formuar. Nga kjo rrjedh arsyeja e dytë që është çështja e statusit, ku Beogradi, përmes Kishës Ortodokse Serbe (KOS) dhe anëtarësimit në UNESCO, dëshiron ta mbajë kontrollin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore, ndërsa Prishtina, përmes kornizës legjislative që ka rrjedhur nga Aneksi V i marrëveshjes së Ahtisaarit, tregon se si KOS-it iu dha statusi i veçantë i mbrojtur, ashtu që Kosova kandidohet për anëtarësim në UNESCO dhe vazhdon më tej drejt njohjes së plotë ndërkombëtare. Ndonëse shmangia nga bisedimet për trashëgiminë kulturore sinjalizon se palët kanë pozicione diametralisht të ndryshme negociuese që e bëjnë të pamundur gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi, arsyeja e tretë mund të përshkruhet si taktike. Meqenëse statusi i trashëgimisë kulturore shpesh përmendet si një *“kompromis i madh”* për marrëveshjen përfundimtare, supozohet se kjo temë, për shkak të ndjeshmërisë dhe kompleksitetit të saj, deri më tani qëllimisht nuk ka qenë në tryezën e bisedimeve.

Ajo që është problematike në arsyen “*taktike*” ka të bëjë me pasojat për të mirat kulturore dhe fetare, të cilat, përkundër përpjekjes ndërkombëtare për t’i mbrojtur ato, shikohen përmes prizmit të kontestit për statusin. Gjersa për Beogradin, manastiret dhe kishat janë dëshmi e së drejtës për territorin që konsiderohet tokë e shenjtë serbe, për Prishtinën, objektet fetare ortodokse me status të veçantë janë simbole të delegjimit të pushtetit sovran të Kosovës. Kalimi i kohës e ka thelluar distancën etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve, ndërsa shmangia e bisedimeve për statusin e monumenteve kulturore dhe fetare zgjon ndjenja të forta identiteti që paralizojnë të gjitha përpjekjet e deritanishme për pajtim dhe normalizim të marrëdhënieve.

Analiza duhet të hedhë dritë mbi rëndësinë e kësaj teme, e cila pasqyrohet në të paktën dy arsye. E para është ngarkesa e fortë emocionale që kjo çështje zgjon në kontekstin e vazhimit të negociatave ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe arritjen e një marrëveshjeje eventuale. Në kuadër të një sondazhi të opinionit publik të realizuar vitin e kaluar në territorin e Republikës së Serbisë, 57.1% e qytetarëve janë shprehur se një kërcënim i mundshëm i trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë mund t’i motivojë ata drejt aktivizimit politik dhe shoqëror. Gjithashtu, midis tri çështjeve të para prioritare në kontekstin e marrëveshjes përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve, madje 82.6% e qytetarëve theksuan nevojën për një marrëveshje që e rregullon statusin e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Dy temat tjera janë garantimi dhe respektimi i të drejtave të serbëve të Kosovës (89%) dhe menaxhimi i burimeve natyrore (83.5%). Njohja eventuale e pavarësisë së Kosovës është e pranueshme për 36.4% të qytetarëve, por ndër kushtet ceket edhe realizimi i eksterritorialitetit për manastiret e KOS-it.<sup>1</sup>

Arsyeja e dytë është përplasja diplomatike ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në nivelin ndërkombëtar në vitin 2015, për shkak të kandidaturës së Kosovës për anëtarësim të plotë në UNESCO. Serbia këmbëngulte që anëtarësimi eventuale i Kosovës në organizatat ndërkombëtare të ishte produkt i procesit negociues në të cilin, në rastin e UNESCO-s, së pari të definohej statusi i përhershëm i trashëgimisë kulturore. Kosova, nga ana tjetër, konsideronte se i kishte përmbushur të gjitha detyrimet nga pakoja e Ahtisaari dhe kushtet e përcaktuara gjatë periudhës së “*pavarësisë së mbikëqyrur*”, dhe me legjislacion siguroi status të veçantë për trashëgiminë kulturore serbe dhe kishte arritur të gjitha kushtet për anëtarësim në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Sidoqoftë, kandidaturat e dështuara për anëtarësimin e Kosovës në UNESCO dhe më vonë në INTERPOL, e kontaminuan procesin e gjithmbarshëm negociator dhe u reflektuan në të drejtat dhe garancitë e deritanishme për komunitetin serb në Kosovë. Përfshirja normative u shndërrua në diskriminim ndaj KOS-it dhe të drejtave fetare të komunitetit serb përmes një numër shkeljesh të kornizës ligjore të miratuar.

---

<sup>1</sup> Normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nga perspektiva e qytetarëve – Çfarë dimë dhe çfarë ndjëmë? Qendra për dialog shoqëror dhe iniciativa rajonale, Beograd, 2019.



Mbivotimi në organizatat ndërkombëtare është shkatërrimtar për përpjekjet e negociatave të bëra deri më tani. Prandaj, qëllimi kryesor i kësaj analize është të tregojë nevojën për dialog për statusin e trashëgimisë serbe në vazhdimin eventual të procesit dhe para se të arrihet marrëveshja përfundimtare, në mënyrë që të shihen të gjitha çështjet e hapura, përvojat e zbatimit të kornizës normative të deritanishme, si dhe pasojat e zbatimit eventual të eksterritorialitetit, sistemit të enklavave ose kondominiumit ndaj trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe. Bindje e qartë e autorëve të analizës është se tejkalimi i kontestit ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, kryesisht varet nga zgjidhja e statusit të trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe në Kosovë. Me qëllim të prezantimit të kompleksitetit të problemit, në pjesën e parë të analizës i jemi qasur paraqitjes së garancive që rrjedhin nga plani i Ahtisaarit, Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura dhe atmosferës socio-politike në të cilën janë definuar të drejtat e KOS-it. Gjithashtu, në analizë trajtohen në mënyrë të detajuar shembujt e keqpërdorimit dhe mosrespektimit të kornizës normative të miratuar, kritikën ndaj statusit “*special*” për trashëgiminë serbe, si dhe kontestet e hapura ndërmjet KOS dhe autoriteteve lokale në Kosovë. Në pjesën e dytë, në analizë ofrohen modele alternative për trashëgiminë kulturore dhe fetare përmes analizës krahasuese të statusit special të vendeve të shenjta në Evropë, si dhe shembujt të zgjidhjeve territoriale për njësi më të vogla.

## ZBATIMI I PLANIT TË AHTISAARIT NDËRMJET PAVARËSISË SË MBIKËQYRUR DHE REALIZIMIT TË PAMBIKËQYRUR

„Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës”, që në të folurën e përditshme quhet “*plani i Ahtisaarit*” sipas të dërguarit të posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, u bë baza për shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe për modelin kushtetues. Me dispozitat e tij të detajuara, “*plani i Ahtisaarit*” synonte që në mënyrë normative t’i precizonte të gjitha mekanizmat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe t’i obligonte përfaqësuesit politikë të Kosovës që në procesin e shtetndërtimit të respektonin dhe promovonin karakterin multikulturor të shoqërisë dhe se me veprimtarinë e vet të parandalonin përsëritjen e çfarëdo sulmi të motivuar etnikisht ose fetarisht. Miratimi i Ligjit për zonat e mbrojtura, Ligji për qendrën historike të Prizrenit dhe Ligji për fshatin Hoçë e Madhe paraqet zbatim të drejtpërdrejtë të Propozimit Gjithëpërfshirës në legjislacionin e Kosovës.

Aneksi V i kushtohet trashëgimisë fetare dhe kulturore të komunitetit serb. Aty thuhet qartë se „*Kosova do ta njeh Kishën Ortodokse Serbe në Kosovë, duke përfshirë manastiret, kishat dhe objektet tjera që shfrytëzohen për qëllime fetare si pjesë integrale e Kishës Ortodokse Serbe me seli në Beograd*”.<sup>2</sup> Propozimi garanton paprekshmërinë e pronës së KOS-it si dhe pamundësinë e shpronësimit të saj, dhe se kisha ruan të drejtën e diskrecionit “për të menaxhuar pronën e saj dhe qasjen në hapësirat dhe objektet e saj”.<sup>3</sup> Pavarësisht nga statusi i saj i veçantë, i cili përfshin mbrojtjen, të drejtat, privilegjet dhe imunitetin, KOS-i është i detyruar të veprojë „*në pajtim me ligjet e Kosovës*”.<sup>4</sup>

Mbrojtja e objekteve të trashëgimisë kulturore përmendet si detyrim në gati të gjitha dokumentet ndërkombëtare pas konfliktit të vitit 1999. Meqenëse asnjëherë nuk është zbatuar dispozita e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për kthimin e personelit të RF të Jugosllavisë me mision sigurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore serbe, atë rol e morën përsipër misioni i UNMIK-ut dhe KFOR-i në kuadër të NATO-s. Sipas planit të Ahtisaarit, detyrimi për të garantuar sigurinë e pasurive kulturore u takon agjencive ligj-zbatuese të Kosovës, e veçanërisht Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).<sup>5</sup> Plani i Ahtisaarit përfshin edhe një listë gjithëpërfshirëse prej 44 zonave mbrojtëse, qëllimi i të cilave është:

„*të sigurohet një ekzistim dhe funksionim paqësor i objekteve të mbrojtura; të ruhet mjedisi historik, kulturor dhe natyral, duke përfshirë mënyrën e jetës monastike të klerit; dhe të parandalohet zhvillimi negativ përreth tyre, duke siguruar kushtet më të mira të mundshme për zhvillim harmonik dhe të qëndrueshëm të komuniteteve të cilat banojnë në hapësirat përreth këtyre objekteve*”.<sup>6</sup>

<sup>2</sup> Plani i Ahtisaarit, Aneksi V, neni 1.2

<sup>3</sup> Po aty, neni 1.5

<sup>4</sup> Po aty, neni 1.1

<sup>5</sup> Po aty, neni 3.1.1

<sup>6</sup> Po aty, neni 4.1

Edhe pse zonat e veçanta janë përcaktuar qartë me harta, territori që i rrethon objektet e mbrojtura nuk është shpronësuar, por vetëm se janë vendosur kufizimet në shfrytëzim: ndalohet „ndërtimi ose zhvillimi industrial siç është: zbulimi dhe eksploatimi i resurseve minerale; ndërtimi i pendave, i centraleve për prodhimin e energjisë ose rrjetit të energjisë elektrike, furrave dhe fabrikave, dhe rrugëve transit në viset rurale, si dhe ndërtimi ose zhvillimi që shpie në shpyllëzimin ose ndotjen e ambientit”.<sup>7</sup>

Aktivitetet vijuese të vetëqeverisjes lokale ose të individëve mund të kufizohen ose kushtëzohen nga pëlqimi i KOS-it:

„a) ndërtimet komerciale ose zhvillimet siç janë: ndërtesat apo godinat më të gjata se manastiri/kisha/monumenti kulturor që duhet mbrojtur, rrugët/rrugicat, ndërtimet, ndërtimi i depove, punëtorive, dyqaneve, restoranteve, bareve, kafiterive, hoteleve/moteleve, kiosqeve dhe stendave të ushqimit, pompave të benzinës dhe qendrave për riparimin e automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës dhe çdo ndërtim në përmasa më të mëdha nëpër rajonet rurale; b) tubimet publike, rekreative dhe zbavitëse; c) urbanizimi i tokës bujqësore”.<sup>8</sup>

Në rast kontesti, parashihet funksionimi i Këshillit Zbatues dhe Mbikëqyrës (KZM), i përbërë nga përfaqësues të autoriteteve lokale, KOS-i dhe misionet ndërkombëtare.<sup>9</sup> Në procesin e mëvonshëm të vendim-marrjes të KZM-së, u shtrua pyetja nëse ky ishte organ me kompetenca ekzekutive apo këshillëdhënëse. Përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës insistuan në karakterin këshillëdhënës, duke theksuar se qeveria është autoriteti përfundimtar. Nga ana tjetër, KOS-i konsideroi se vendimet e KZM-së nuk ishin subjekt i aprovimit të qeverisë dhe shumë herë e kushtëzuan pjesëmarrjen e tyre me karakterin ekzekutiv të Këshillit.

Analiza e mandatit të dhënë KZM-së, tregon se Qeveria e Kosovës ka detyrim të sigurojë zbatimin e “vendimeve” të KZM-së dhe jo të “rekomandimeve”, “këshillave” ose “opinioneve”.<sup>10</sup> Sidoqoftë, ky interpretim i dyfishtë e paralizoi të gjithë kornizën e mbrojtjes së veçantë, duke i mundësuar Qeverisë së Kosovës që me vetë-iniciativë ta definojë veten si organin përfundimtar gjykues në ndonjë kontest të mundshëm, përkundër qëndrimit negativ të KOS-it në lidhje me aktivitetet në zonat e përcaktuara si zona të veçanta mbrojtëse.

Ndonëse nuk e pranoi versionin përfundimtar të planit të Ahtisaarit, Qeveria e Serbisë, në kuadër të negociatave të Vjenës, formuloi një numër amendamentesh. Megjithatë, të gjitha propozimet që vunë në pikëpyetje statusin e Kosovës si shtet i pavarur, u refuzuan. Sidoqoftë, ekipi i autorëve të planit të Ahtisaarit e humbi mundësinë për të miratuar disa amendamente, siç ishte kërkesa që urbanizimi i tokës bujqësore të shënohet si i ndaluar dhe jo si veprimtari e

<sup>7</sup> Po aty, neni 4.1.1

<sup>8</sup> Po aty, neni 4.1.2

<sup>9</sup> Po aty, neni 5

<sup>10</sup> Research Institute of Development and European Affairs, *The issue of Serbian Cultural Heritage in Kosovo in the context of an eventual 'Grand Finale' between Kosovo and Serbia*, Pristina, 2019, pp. 10-11.

kufizuar në zonat e mbrojtura.<sup>11</sup> Ky propozim fitoi rëndësi të veçantë pas përvojës negative të KOS-it me rrezikimin e tërësisë ambientale të komplekseve të manastireve dhe mënyrës monastike të jetës.

Jo rrallë herë autoritetet lokale janë treguar të shurdhra ndaj kufizimeve dhe kushteve të përcaktuara me Ligjin për zona të veçanta të mbrojtura. Komuna e Rahovecit, me ndërtimin e rrugës lokale hyri në zonën e mbrojtur të manastirit të Zoçishtit pa pëlqimit ligjërish të detyrueshëm të KOS-it, si dhe pa kompensim për tokën e marrë, ndërsa autoritetet e komunës së Pejës vazhduan me ndërtimin e një shtegu për këmbësorë dhe biçikleta ngjitur me manastirin e Patriarkanës së Pejës përkundër përgjigjes negative të KOS-it dhe mungesës së zgjidhjes së kompromisit në procesin e ndërmjetësimit.<sup>12</sup> Kontesti ndërmjet Manastirit të Deçanit dhe Komunës së Deçanit dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbi tokën që gjendet në afërsi të manastirit, si dhe shkelja e zonës së veçantë të Novobërdës me punimet në kishën e Shën Nikollës do të trajtohen në pjesën e veçantë të kësaj analize.

Gjithashtu, duhet të kihet parasysh se zgjidhja e parashikuar me zona i ka mangësitë e saj praktike. Nga njëra anë, brenda zonave nuk kishte asnjë ndërhyrje në pronat e regjistruara, ndërsa në praktikë mundësia e pronarëve për të shfrytëzuar dhe disponuar me to ishte ulur ndjeshëm.<sup>13</sup> Nga ana tjetër, zonat e veçanta për manastire janë paramenduar për të „*ruajtur identitetin e tyre historik dhe mjedisin natyror, përfshirë jetën monastike të klerit*”,<sup>14</sup> ndërsa parashihej edhe mundësia e urbanizimit të tokës bujqësore, që padyshim e vë në pikë pyetje atë që u cek më sipër. Prandaj, në vazhdimin eventual të negociatave duhet t'i kushtohet vëmendje mundësisë së shpronësimit të tokës me qëllim të realizimit të idesë fillestare. Siç e cek Arraiza, i gjithë sistemi i zonave të veçanta të mbrojtura ka rezultuar në një aranzhim *ad hoc* përmes ndërhyrjes vendimtare ndërkombëtare me qëllim të mbrojtjes nga urbanizimi i dëmshëm, ndërtimet e paligjshme, vandalizmi dhe vjedhjet.<sup>15</sup>

Plani i Ahtisaarit parasheh edhe kthimin e pronave të KOS-it në Kosovë, gjë që deri më sot nuk është iniciuar: „*Një nga prioritetet në Kosovë do të jenë çështjet që lidhen me kthimin e pronave, përfshirë ato që lidhen me çështjet e pronës së KOS-it. Kosova do të themelojë mekanizma të pavarur për të krijuar një kornizë politike, legislative dhe institucionale për zgjidhjen e çështjeve të kthimit të pronave. Përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare do të ftohen të marrin pjesë në mekanizma të tillë, të cilët gjithashtu do t'i përfshijnë përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë*”.<sup>16</sup>

<sup>11</sup> Qeveria e Serbisë, *Amendamentet në „Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës*”, 2007.

<sup>12</sup> OSBE, *Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajshme në Kosovë*, Prishtinë, 2014.

<sup>13</sup> Arraiza, Jose Maria, “A Matter of Balance. Cultural Heritage, Property Rights and Inter-Ethnic Relations in Kosovo”, in: *Seminar on Property and Investment in Jus Post Bellum*, Grotius Centre for International Legal Studies, p. 11.

<sup>14</sup> Plani i Ahtisaarit, Aneksi V, neni 4.1

<sup>15</sup> Arraiza, Jose Maria, “A Matter of Balance. Cultural Heritage, Property Rights and Inter-Ethnic Relations in Kosovo”, in: *Seminar on Property and Investment in Jus Post Bellum*, Grotius Centre for International Legal Studies, p. 6.

<sup>16</sup> Plani i Ahtisaarit, Aneksi V, neni 6.1

## TRASHËGIMIA FETARE DHE KULTURORE SERBE – KONTESTIMI I SË DREJTËS NË STATUSIN E DHËNË

Përveç që kanë dalë si obligime nga Plani i Ahtisaarit , Ligji për zonat e mbrojtura, Ligji për qendrën historike të Prizrenit dhe Ligji për fshatin Hoçë e Madhe janë të një rëndësie të veçantë për karakterin shumetnik të Kosovës, sepse „*njohja e trashëgimisë kulturore të një grupi simbolizon njohjen e identitetit kulturor të atij grupi, si dhe praninë e tij historike në një territor të caktuar*”.<sup>17</sup> Duke studiuar atmosferën socio-politike para miratimit të dy ligjeve të përmendura, Lončar vjen në përfundim se kundërshtimi i fortë është pasojë e „*perceptimit se serbët dhe Kisha Ortodokse Serbe janë kërcënimi kryesor për shtetësinë e Kosovës*”.<sup>18</sup>

Komunitetit serb i atribuoheshin karakteri ekskluzivist dhe të drejtat pronësore që tjetërsojnë trashëgiminë kulturore nga qytetarët e Kosovës, dhe në debat ishte e pranishme narrativa tashmë e njohur për kishat ortodokse të ndërtuara mbi themelet e tempujve iliro-shqiptarë dhe papranueshmëria që kisha ortodokse në Kosovë ta ketë atributin etnik serb. Emëruesi i përbashkët i diskutimeve të përfaqësuesve politikë për projektligjet ishte përmendja e komunitetit serb ekskluzivisht në kontekstin e armiqësisë dhe fajit, sesa si një grup i pakicës të cilës i sigurohet mbrojtje për trashëgiminë kulturore të rrezikuar.<sup>19</sup>

Në disa analiza që vijnë nga komuniteti akademik ose organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, mbizotëron qasja e njëanshme ku propozohet rishikimi i zbatimit të Aneksit V, si model i qëndrueshëm për ruajtjen e pasurive kulturore. Kështu që, termi "*i veçantë*" në kontekstin e zonave të mbrojtura interpretohet si diskriminues, sepse krijon perceptimin se këto vende janë "*më të vlefshme*" sesa objektet e tjera të trashëgimisë kulturore në Kosovë.<sup>20</sup> Po ashtu, Hoxha e sheh se situata me trashëgiminë kulturore në Kosovë është alarmante, por ndër prioritetet në të ardhmen ai sheh kërkesën për „*qasje në manastiret dhe kishat ortodokse*”.<sup>21</sup> Në situatën kur me punë të ndryshme ndërtimore shkelen rëndë zonat e veçanta të mbrojtura, theksohet jo profesionalizmi i KOS-it në praktikën e ruajtjes së objekteve që i menaxhon. Kjo krijon perceptimin publik në Kosovë në të cilën KOS-i paraqitet si aktor rrezikues, e jo i rrezikuar.

---

<sup>17</sup> Lončar, Jelena, Cultural Heritage in Kosovo: Strengthening Exclusion through Inclusive Legislation, in: *Figuring out the Enemy: Re-Imagining Serbian-Albanian Relations*, edited by Aleksandar Pavlović, Adriana Zaharijević, Rigels Halili, and Draško Gazela Pudar, Belgrade, 2015, p. 412.

<sup>18</sup> Po aty, p. 415.

<sup>19</sup> Po aty, p. 417,421.

<sup>20</sup> Hisari, Lorika and Fouseki, Kalliopi, *Post-War Cultural Heritage Preservation in Kosovo: Rethinking the Implementation of Ahtisaari Plan Annex V*, *Heritage* 2020, 3(1), p. 102,111.

<sup>21</sup> Hoxha, Gjejlane, *Legal protection of Cultural Heritage in Kosova-past, present and future*, *Balkanlarda Osmanlı Vakıfları ve Eserleri Uluslararası Sempozyumu*, 2012, p. 236.

Është paradoksale akuzimi se presioni ndërkombëtar ishte i njëanshëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore të serbe, duke e injoruar “*dëmtimin, vandalizmin dhe plaçkitjen e trashëgimisë kulturore të Kosovës gjatë vitit 1998/99 nga ana e forcave serbe*”.<sup>22</sup> Deri në vitin 2011, 70% e rindërtimit të planifikuar të objekteve të KOS-it të dëmtuara gjatë trazirave të marsit 2004 ishin realizuar nga buxheti i Kosovës, dhe pas heqjes së pavarësisë së mbikëqyrur të Kosovës vazhdimi i rindërtimit nuk ishte i mundur sepse „*KOS-i nuk u pajtua me formatin e ri të propozuar nga Qeveria e Kosovës*”.<sup>23</sup> Autoritetet në Prishtinë kishin dhe kanë akoma autoritet të plotë për t'u përkushtuar në mënyrë të barabartë për restaurimin dhe ruajtjen e tërë trashëgimisë kulturore në Kosovë, ndërsa qëllimi i aktorëve ndërkombëtarë ishte të siguronin garanci të posaçme për pasuritë kulturore që ishin në shënjestër në periudhën e pas konfliktit dhe që ende konsiderohen të rrezikuara. Siç vihet në përfundim në analizën që u kushtohet objekteve kulturore: „*vlera estetike, rëndësia e identitetit serb dhe cenueshmëria e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë kanë çuar deri në atë që bashkësia ndërkombëtare t'i jep asaj statusin e të qenit e posaçme në shtetin e ri të Kosovës*”.<sup>24</sup>

Ekzistojnë edhe narrativa, të cilat përmes interpretimeve kuazi-historike në kontekstin e diskriminimit sistemor aktual të komunitetit serb dhe trashëgimisë së tij fetare dhe kulturore kanë prapavijë të qartë politike për të hequr të drejtat që KOS-i i gëzon të paktën në mënyrë normative në Kosovë. „*Trashëgimia kulturore e Kosovës nuk u përket shqiptarëve, ashtu siç kishat ortodokse nuk u përkasin serbëve ... Në kohën e ndërtimit të Patrikanës së Pejës ose Manastirit të Graçanicës, nuk kishte serbë atje, vetëm ortodoksë. Paraardhësit e shqiptarëve ishin ortodoksë dhe paraardhësit e serbëve ishin ortodoksë*”.<sup>25</sup>

Në njërën nga analizat e fundit, mbiemri “*serbe*” për trashëgiminë kulturore interpretohet si “*etnizim i monumenteve të trashëgimisë kulturore*”, duke iu referuar karakterit tashmë të përmendur “*universal*” të krishterë të objekteve në kohën kur ato u krijuan.<sup>26</sup> Pikërisht ky narrativ, për prejardhjen “*burimore*” jo serbe të manastireve dhe kishave, ngre tensione në Serbi dhe bindjen se Prishtina në thelb nuk është e interesuar për mbrojtjen e tyre, dhe se kuadri ekzistues është në vetvete i paqëndrueshëm. Gjithashtu, kritika u drejtua për shkak të pranisë së policisë dhe ushtrisë në objektet e trashëgimisë kulturore, që është “*një fotografi që i shkëput ato nga të gjitha monumentet kulturore, historike dhe fetare*”.<sup>27</sup> Zonat e veçanta shihen si një formë izolimi „*në kundërshtim me të gjitha parimet dhe standardet e mbrojtjes aktive dhe*

<sup>22</sup> Hisari, Lorika and Fouseki, Kalliopi, *Post-War Cultural Heritage Preservation in Kosovo: Rethinking the Implementation of Ahtisaari Plan Annex V*, Heritage 2020,3(1), p. 103.

<sup>23</sup> Research Institute of Development and European Affairs, *The issue of Serbian Cultural Heritage in Kosovo in the context of an eventual ‘Grand Finale’ between Kosovo and Serbia*, Pristina, 2019, p. 14.

<sup>24</sup> Po aty, p. 2

<sup>25</sup> Artan Krasniqi „*Zgjimi i trashëgimisë kulturore të Kosovës*”, autori i tekstit: Valmir Mehmetaj, gjendet në <https://bit.ly/2zgHChH>, qasja e fundit më 8 maj 2020.

<sup>26</sup> Emancipimi Civil Ma Ndryshe, *Analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore*; Seria e analizave “*Çka shkoi ters?*”, Prishtinë, 2013, f. 15.

<sup>27</sup> Po aty, p. 21.



*efikase të trashëgimisë kulturore*”.<sup>28</sup> Bazuar në këtë analizë, mund të vihet në përfundim se pjesëtarët e KFOR-it dhe të SHPK-së e uzurpojnë qasjen në objektet fetare dhe kulturore me iniciativën e tyre, dhe jo sepse në mesin e atyre objekteve, kanë qenë katër manastire nga lista e UNESCO-s të objekteve të rrezikuara të trashëgimisë botërore që nga viti 2004.<sup>29</sup> Arsyeja për këtë është se trazirat e motivuara etnikisht ndodhën në të njëjtin vit, ku kishte sulme mbi më shumë se tridhjetë objekte ortodokse.<sup>30</sup> Ndonëse trazirat e këtyre përmasave nuk janë përsëritur, KOS-i vazhdoi të përballet me kërcënime për sigurinë e objekteve fetare dhe kulturore, dhe më pas me prishjen e tërësisë së mjedisit historik dhe natyror nga punime të ndryshme ndërtimore të paligjshme.

Si pjesë e raporteve gjysmë vjetore mbi përparimin e negociatave që nga viti 2015, Zyra për Kosovë dhe Metohi përmendi sulme ndaj anëtarëve të komunitetit serb. Incidente si shkrimi i mbishkrimeve „*ISIS-i*” dhe „*Kalifati po vjen*” në objektet monastike përcjellëse, kërcënimet nga personat që posedonin armë, vjedhja dhe shkatërrimi i pronës së luajtshme monastike, dhe lëndimet ndaj besimtarëve<sup>31</sup> tregojnë për një hendek të kontestuar publikisht ndërmjet kornizës normative përfshirëse të Kosovës dhe ndjenjës reale të kërcënimit.

Ndonëse ende nuk është miratuar ligji për trashëgiminë kulturore, me të cilin mund të tejkalohen mangësitë e perceptuara në zbatimin e kornizës ligjore për trashëgiminë kulturore dhe fetare serbe, një hap pozitiv përpara është miratimi i Strategjisë së Trashëgimisë Kulturore të Kosovës. Ndër të tjera, në Strategji thuhet se:

*“Kushtetuta dhe dokumentet tjera përkatëse, përfshirë Letrën e institucioneve të Kosovës drejtuar Delegacioneve Kombëtare të UNESCO-s të datës 7 tetor 2015 e cila përmbledh angazhimet e Kosovës lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare mbi bazën e dispozitave të Aneksit V të PGJS-së, formojnë bazën institucionale për hartimin e kësaj Strategjie Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore 2017-2027.”*<sup>32</sup>

Kjo strategji tani për tani paraqet dokumentin e vetëm në fuqi të Qeverisë së Kosovës në të cilin theksohet qartë e drejta e plotë e diskrecionit të KOS-it:

*„Lidhur me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e vendeve që janë në pronësi të KOS-it, kjo e fundit do të ketë diskrecionin e plotë në menaxhimin e dhe qasjen në pronat e saj kulturore, përfshirë*

---

<sup>28</sup> Po aty, f. 21.

<sup>29</sup> UNESCO, *List of World Heritage in Danger*, gjendet nw <https://bit.ly/3bcINvJ>, qasja e fundit 8 maj 2020.

<sup>30</sup> Arraiza, Jose Maria, “A Matter of Balance. Cultural Heritage, Property Rights and Inter-Ethnic Relations in Kosovo”, in: *Seminar on Property and Investment in Jus Post Bellum*, Grotius Centre for International Legal Studies, p. 4.

<sup>31</sup> Zyra për KeM, *Raporti mbi progresin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018*.

<sup>32</sup> Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës, „*Strategjia Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore 2017-2027*”, f. 15.

*konservimin dhe restaurimin e monumenteve në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe duke vepruar në përputhje me ligjet e Kosovës. Përveç kësaj, do të përfundohet procesi i rindërtimit të monumenteve në bazë të “Raportit të Vlerësimit Teknik për Programin e Rindërtimit të Objekteve Ortodokse Serbe Fetare të Dëmtuara gjatë Marsit të vitit 2004 në Kosovë” të Këshillit të Evropës, hartuar në prill 2012.”<sup>33</sup>*

---

<sup>33</sup> Po aty, f. 31.



## KONTESTET KRYESORE TË KISHËS ORTODOKSE SERBE DHE AUTORITETEVE NË KOSOVË

Njëra nga pyetjet që shtrihet gjatë çdo debati mbi trashëgiminë kulturore serbe është numri i saktë i manastireve, kishave dhe objekteve të tjera në pronësi të KOS-it. Svirca thekson se për të promovuar të drejtat në territorin e Kosovës, përfaqësuesit politikë serbë në paraqitjet e ndryshme publike përmendin shifrën e mbi një mijë objekteve ortodokse serbe, ndërsa misioni i UNMIK-ut në bashkëpunim me OSBE-në, regjistroi 114 objekte të KOS-it, duke përfshirë kapelat dhe objektet gjysmë të rrënuara.<sup>34</sup> Nga ana tjetër, plani i paraqitur nga Zyra për Kosovë dhe Metohi në vitin 2018 para përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, në të cilin kërkohen garanci për KOS-in, se ka të drejtën e plotë të disponojë me pronën e saj për një periudhë të pakufizuar të regjimit të vendosur të mbrojtjes juridike, përmend 44 objekte.<sup>35</sup> Megjithëse plani nuk është publik, kjo shifër ndoshta përkon me listën e 44 objekteve me zona të veçanta të mbrojtura të përmendura në planin e Ahtisaarit.<sup>36</sup> Mes tyre janë edhe lokacionet rreth të cilave ekziston një kontest i veçantë ndërmjet KOS-it dhe autoriteteve në Kosovë.

### Manastiri i Deçanit

Një nga problemet më të mëdha të KOS-it me autoritetet në Kosovë ka të bëjë me çështjen e pronave mbi tokën e Manastirit të Deçanit. Fjala është për dy ngastra prej 23 hektarësh, të cilat paraqesin pjesën e nacionalizuar nga prona e gjithmbarshme në 1946, dhe të cilat gjatë procesit të kthimit të pronave në vitin 1997 iu kthyen manastirit nga ana e Qeverisë së Serbisë. Ngastrat në fjalë ishin shfrytëzuar nga ana e dy ndërmarrjeve në pronësi shoqërore gjatë socializmit. Pas luftës, me ndërhyrjen e UNMIK-ut, kontesti për pronësinë e tokës iu përcoll gjykatës. Me vendimin e vitit 2012, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi në favor të manastirit. Megjithatë, për shkak të presionit publik, Kolegji i Apelit i Gjykatës Supreme në vitin 2015 e revokoi atë aktgjykim dhe vendosi që Gjykata Supreme nuk kishte juridiksion dhe e ktheu çështjen për rigjykim në Gjykatën Themelore në Pejë.<sup>37</sup>

KOS-i iu drejtua Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, e cila në vitin 2016 konstatoi shkelje të të drejtave të parashtruesit të kërkesës dhe konfirmoi vendimin fillestar të Gjykatës Supreme nga

---

<sup>34</sup> Svirca, Baki, Sacred Places and Religious Institutions in Kosova-Comparative Legal and Religious Approach, in: *Between Cultural Diversity and Common Heritage Legal and Religious Perspectives on the Sacred Places of the Mediterranean*, edited by Silvio Ferrari and Andrea Benzo, 2014, p. 261.

<sup>35</sup> Večernje novosti, *Zaštita za 44 svetinje i spomenika*, 10. oktobar 2018., gjendet në <https://bit.ly/2yBVpzi>, e parë së fundmi më 8. maj 2020.g.

<sup>36</sup> Plani i Ahtisaarit, Aneksi V, neni 4.

<sup>37</sup> Research Institute of Development and European Affairs, *The issue of Serbian Cultural Heritage in Kosovo in the context of an eventual 'Grand Finale' between Kosovo and Serbia*, Pristina, 2019, p. 16.

viti 2012 që toka i përket manastirit.<sup>38</sup> Megjithëse Gjykata Kushtetuese e përkufizoi këtë vendim si të formës së prerë dhe detyruese, ai nuk është zbatuar deri më tani, dhe pengesa kryesore janë autoritetet lokale të komunës së Deçanit. Pengimi i ekzekutimit të vendimit të gjykatës provokoi reagimin nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, përfshirë edhe misionin e BE-së në Kosovë, i cili publikisht u bëri thirrje autoriteteve të Kosovës që të respektojnë sundimin e ligjit, duke deklaruar se vendimi duhet të zbatohet pa vonesë.<sup>39</sup>

Kontesti i dytë ka të bëjë me planin e Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e rrugës magjistrale ndërkombëtare Deçan-Plavë, e cila do të kalonte nëpër një zonë të veçantë të mbrojtur të manastirit. Rruga e planifikuar në gjatësi prej 35 kilometrash do të shfrytëzonte trasenë e rrugës ekzistuese rurale prej 4.5 kilometra që kalon pikërisht përpara hyrjes kryesore të manastirit.<sup>40</sup> Punimet janë ndalur përkohësisht për shkak të presionit ndërkombëtar, por autoritetet lokale të Deçanit po paralajmërojnë vazhdimin e tyre, megjithëse me Ligjin për zonat e veçanta ndalohet ndërtimi i rrugëve transit.<sup>41</sup>

## Novobërda

Në qershor të vitit 2019, Ramush Haradinaj, kryeministri i atëhershëm i Kosovës, paralajmëroi një projekt me rëndësi të veçantë për kulturën dhe historinë e Kosovës - rinovimi i kishës së Shën Nikollës në Novobërdë, e cila do të mbështetet nga Qeveria e Gjermanisë. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Qeverisë së Kosovës prezantoi mbetjet e kishës së Novobërdës si objekt i cili konsiderohet të ketë qenë një katedrale katolike tre-anëshe. Megjithatë, pasi që bëhet fjalë për një zonë të veçantë e të mbrojtur, menjëherë pasoi demanti i ambasadorit gjerman Christian Heldt, i cili deklaroi se nuk do të punohet asgjë në Novobërdë pa pëlqimin e KOS-it.<sup>42</sup>

Gjatë vizitës së tij në Novobërdë, fortifikatës të cilës pas luftës iu ndryshua emri në Artanë, Kadri Veseli, kryetari i atëhershëm i Kuvendit të Kosovës, njoftoi se do të bëhen punime të gjera për restaurimin e kalasë dhe deklaroi se „*Serbia po përpiqet më kot të asimilojë kulturën dhe trashëgiminë tonë*“.<sup>43</sup> Përveç falsifikimit të dukshëm të interpretimit të trashëgimisë së monumentit, kjo është një shkelje flagrante e Ligjit për zona të veçanta të mbrojtura, ndërsa kontesti me KOS-in vazhdon ende.

<sup>38</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, AGJ943/16 Aktgjykimi 1-18, Prishtinë, 2016.

<sup>39</sup> The European Union Office in Kosovo” EU is concerned by a lack of implementation of Constitutional Court ruling on the land dispute case in Decan/e”, April 2017.

<sup>40</sup> Research Institute of Development and European Affairs, *The issue of Serbian Cultural Heritage in Kosovo in the context of an eventual ‘Grand Finale’ between Kosovo and Serbia*, Pristina, 2019, p. 5.

<sup>41</sup> Plani i Ahtisaarit, Aneksi V, neni 4.1.1

<sup>42</sup> Tasić, J. „*Haradinaj proglasio pravoslavnu crkvu Svetog Nikole u Novom Brdu za rimokatoličku katedralu*”, *Danas*, 07. jun 2019., gjendet në <https://bit.ly/3ch6Kn8>, e parë së fundmi më 8. maj 2020.g.

<sup>43</sup> RTS, „*Veselji: Novo Brdo dragulj naše kulturne baštine*”, 17. avgust 2019., gjendet në <https://bit.ly/2WevSVV>, e parë së fundmi më 8. maj 2020.g.

## Manastiri i Arkangjelit të Shenjtë në Prizren

Ministria e Kulturës e Kosovës dy herë e ka bllokuar vazhdimin e punimeve për rinovimin e tempullit të Shën Nikollës në kompleksin e Manastirit të Arkangjelit të Shenjtë, te Prizreni. Përfaqësuesit e Dioqezës së Rashkë-Prizren vlerësuan se kjo është një „*strategji e re e ngulfatjes institucionale të lirive dhe të drejtave të KOS-it*”<sup>44</sup>, pasi që në Këshillin për Zbatim dhe Mbikëqyrje u arrit marrëveshja për rinovimin e tempullit. Në punën e Këshillit, përveç përfaqësuesve të KOS-it, marrin pjesë edhe dy përfaqësues të qeverisë së Kosovës – Ministri i Kulturës dhe Ministri i Planifikimit Hapësinor, si dhe kryetarët e zyrave të BE-së dhe OSBE-së në Kosovë.

Përkundër dakordimit, Ministria e Kulturës nuk lëshoi leje ndërtimi dhe në vend të kësaj dha një urdher për pezullimin e punimeve që duhej të fillonin për shkak të afatit të shfrytëzimit të fondeve nga donacioni ndërkombëtar. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës nuk e dha pëlqimin e tij për këtë projekt, pasi që kisha në fjalë ishte dëmtuar në vitin 1615 dhe se deri më sot ka mbetur vetëm rreth 20% e strukturës fillestare. Prandaj, ne nuk mund të flasim për përtëritjen si restaurim, por vetëm si një rindërtim që kërkon respektimin e rregullave të veçanta ndërkombëtare për qasjen në ndërtesat e lashta. Gjithashtu, kompleksi i manastirit nuk është i regjistruar në kadastër si pronë e KOS-it, por është në pronësi të Qendrës Rajonale të Trashëgimisë Kulturore nga Prizreni.<sup>45</sup>

Meqenëse me kalimin e kohës kontesti nuk është zgjidhur, ky shpjegim ngre dy pyetje. E para, nëse dokumentacioni në planin e rindërtimit është joadekuat, për atë arsye nuk i janë qasur përgatitjes së një elaborati të përbashkët nga përfaqësuesit e KOS-it dhe Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës, me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe të mundësohet vazhdimi i shfrytëzimit të donacioneve ndërkombëtare? E dyta, nëse kompleksi i manastirit shënohet qartë në hartën e planit të Ahtisaarit si zonë e veçantë e mbrojtur, në të cilën, në përputhje me ligjet e Kosovës, KOS-it i garantohet liria e menaxhimit mbi objektet fetare dhe rinovimin e tyre, në ç’mënyrë magjike ajo pronë është regjistruar në kadastër si pronë e një institucioni tjetër?

## Tempulli Krishti Shpëtimtar në Prishtinë

Gërmimet e paradokohshme në oborrin e tempullit Krishti Shpëtimtar në Prishtinë, në kërkim të varreve masive, e ka aktualizuar statusin e këtij objekti fetar të papërfunduar. Ndërtimi i kishës kishte filluar gjatë viteve 1990 në truallin, i cili në atë kohë i ishte ndarë në mënyrë legale KOS-

<sup>44</sup> Komunikata e Dioqezës Rashkë-Prizren – Ministria e Kulturës e Kosovës ka ndaluar punimet e mëtejme për rindërtimin e Manastirit të Arkangjelit të Shenjtë në Prizren, 12 tetor 2016., gjendet në <https://bit.ly/2L8s42c>, e parë së fundmi më 8 maj 2020.

<sup>45</sup> Research Institute of Development and European Affairs, *The issue of Serbian Cultural Heritage in Kosovo in the context of an eventual ‘Grand Finale’ between Kosovo and Serbia*, Pristina, 2019, p. 18.

it. Sidoqoftë, Universiteti i Prishtinës e konsideron këtë objekt të kontestueshëm për shkak se ai gjendet në hapësirën që në tërësi ishte e destinuar për kampus universitar. Për këtë arsye, Rektorati inicioi një proces gjyqësor i cili përfundoi me aktgjykim të Gjykatës së Apelit të Kosovës në favor të KOS-it.<sup>46</sup>

Kisha para publikut paraqitet si „*e Millosheviqit*”, që me kalimin e viteve ishte si një tualet publik, strehë për të pastrehët, një studio për regjistrimin e spoteve muzikore dhe një objekt ku ngjiten alpinistë ekstremë. Pas djegies së gomave brenda tempullit, institucionet e Kosovës e ndaluan aksionin e pastrimit të tempullit, i cili u iniciua nga Peshkopi Teodosije, megjithëse me vendim të gjykatës u konfirmua pronësia e KOS-it mbi këtë objekt.<sup>47</sup> Gjersa pala shqiptare, lokacionin dhe vetë objektin i konsideron të kontestueshëm, me iniciativën për ta kthyer kishën e papërfunduar në një qendër përkujtimore për viktimat shqiptare, Živojin Rakočević, gazetar dhe drejtor i Shtëpisë së Kulturës në Graçanicë, thekson se pala serbe ka një pikëpamje ndryshe: „*është thellësisht shqetësues fakti që askush nga shqiptarët nuk dëshiron të dalë para këtij Tempulli dhe të thotë: 'Nuk keni të drejtë ta bëni këtë'. Tempulli Krishti Shpëtimtar ishte ndërtuar si domosdoshmëri për 40 mijë serbë që kanë jetuar në Prishtinë. Ai u kthye në përfaqësuesin e tyre, ai dëshmon se ata ishin atje dhe i thërret ata që të kthehen.*“<sup>48</sup>

---

<sup>46</sup> Po aty, f. 17.

<sup>47</sup> Kossev, „*Peshkopi Teodosije me murgj e ka pastruar Tempullin Krishti Shpëtimtar dhe për herë të parë kanë kënduar në të që nga viti '99*”, 11 shtator 2016, gjendet në <https://bit.ly/3cfd4eZ>, e parë së fundmi më 8 maj 2020.

<sup>48</sup> Kosovo Online, „*Rakočević: Në Tempullin Krishti Shpëtimtar në Prishtinë thyhet fati i marrëdhënieve ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve*”, 28 nëntor 2019., gjendet në <https://bit.ly/2YL4HUg>, e parë së fundmi më 8 maj 2020.

## E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE ÇËSHTJA E MBROJTJES SË VENDEVE TË SHENJTA

Pas pjesës së parë, e cila i është kushtuar zbatimit të kornizës normative në fuqi të nxjerrë nga plani i Ahtisaarit, në vazhdim të kësaj analize do të paraqiten përvojat evropiane të mbrojtjes së veçantë të vendeve të shenjta, të cilat mund të aplikohen në definimin eventual të statusit të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë. Meqenëse shpesh në propozimet për objektet e KOS-it përmenden edhe zgjidhjet territoriale, një analizë krahasuese e modeleve të njohura do të paraqitet në rreshtat e mëposhtëm.

E drejta ndërkombëtare nuk parasheh një regjim konsekuent për mbrojtjen e vendeve të shenjta, pasi konventat ekzistuese me rëndësi globale<sup>49</sup> dhe evropiane<sup>50</sup> nuk sigurojnë një regjim unik për mbrojtjen e tyre.<sup>51</sup> Prandaj, në shumicën e rasteve, janë në fuqi regjimet e vendosura nga vet shteti në territorin e të cilit ndodhen vendet e shenjta, ose të cilat janë produkt i një marrëveshje bilaterale. Meqenëse Kosova nuk është anëtare e OKB-së, UNESCO-s dhe Këshillit të Evropës, është e qartë se regjimet e mbrojtjes ndërkombëtare nuk janë *de facto* në fuqi në kuptim sistematik. Nga ana tjetër, siç u shpjegua më lartë, regjimi i mbrojtjes i vendosur nga plani i Ahtisaarit dhe Kushtetuta e më pastajme e Kosovës nuk është zbatuar plotësisht, dhe për më tepër shpesh vihet në pyetje në publik në Kosovë. Në këtë kontekst, qëllimi i këtij studimi është që të ofrohet një pasqyrë e modeleve të tjera ekzistuese, të cilat tani më veç ekzistojnë në Evropë, sa i përket çështjes së mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe, si dhe funksionimit të mëtutjeshëm të KOS-it në territorin e Kosovës.

Ekzistojnë dy shembuj ilustrues që tregojnë se si me sukses mund të rregullohet statusi eksterritorial i kishave dhe objekteve të shenjta: Qyteti i Vatikanit dhe Shteti Monastik Mali Athos në Greqi. Këto dy modele janë të ndryshme, dhe sigurisht që nuk është e mundur të zbatohen plotësisht në rastin e KOS-it në Kosovë. Sidoqoftë, ndonjëra nga zgjidhjet specifike të definuara në këto modele mund të jenë interesante për t'u aplikuar në rregullimin e ardhshëm të statusit të KOS-it në Kosovë.

---

<sup>49</sup> Konventa e UNESCO-s për mbrojtjen trashëgimisë kulturore dhe natyrore e vitit 1972, Konventa mbi mbrojtjen e pasurive kulturore në rastet e konfliktit të armatosur e vitit 1954 (me protokollin plotësues të vitit 1999), Konventa e UNESCO-s për mjetet e ndalimit dhe të parandalimit të importit, eksportit dhe transferimit të paligjshëm të pronësisë së pasurisë kulturore e vitit 1970

<sup>50</sup> Konventa për ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore të Evropës e vitit 1985 dhe Konventa evropiane për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike e vitit 1992 e Këshillit të Evropës

<sup>51</sup> Leanza, Umberto. "General Problems of International Law Concerning Sacred Places." In *Cultural Diversity and Law: Between Cultural Diversity and Common Heritage: Legal and Religious Perspectives on the Sacred Places of the Mediterranean*. Ashgate Publishing Limited, 2014, p. 40.

## **SHEMBUJT E ZGJIDHJEVE TERRITORIALE NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN E VENDEVE TË SHENJTA NË EVROPË**

### **Mali i Shenjtë (Mali Athos)**

Shteti monastik i Malit Athos në gadishullin Athos në Greqi është një shembull unik i një republike monastike autonome në kuadër të një shteti laik modern. Për më shumë se 1000 vjet, Athos-i ka qenë qendër e monasticizmit ortodoks dhe është i një rëndësie të jashtëzakonshme për disa kisha ortodokse. Statusin e veçantë e ka fituar gradualisht që në Perandorinë Bizantine përmes një numri të madh privilegjesh materiale, por edhe ligjore që me kohë e rregulluan një lloj të vetëqeverisjes. Kjo praktikë pak a shumë kishte vazhduar edhe nën Perandorinë Osmane. Statusi special i Malit të Shenjtë më pas u njoh në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara pas Luftës së Parë Botërore. Duke marrë parasysh privilegjet historike, statusi i Shtetit Monastik të Malit Athos është i rregulluar me Kushtetutën e Greqisë,<sup>52</sup> Me kartën themeluese të Malit Athos nga viti 1925, si dhe dokumentet përfundimtare për pranimin e Greqisë në Bashkimin Evropian të vitit 1981.

Gadishulli me 20 manastire dhe territori që i përket atij gëzon vetëqeverisje e cila është zyrtarisht pjesë e Republikës së Greqisë.<sup>53</sup> Mali Athos është nën juridiksionin e drejtpërdrejtë shpirtëror të Patriarkanës Ekumenike në Stamboll, ndërsa menaxhimi praktik, bazuar në dispozitat tradicionale që rrjedhin nga tipikët e manastirit, privilegjet bizantine dhe osmane, i janë besuar institucioneve të Malit Athos. Shteti, përmes funksionit të guvernatorit (dhe zëvendësit të tij) që janë zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Greqisë dhe selia e të cilit gjendet në qytetin Kareja në gadishullin Athos, nga ana e tij kryen një mbikëqyrje deri diku të kufizuar të funksionimit të Malit Athos, si dhe deri në një farë shkalle të rendit dhe qetësisë publike.<sup>54</sup> Me fjalë të tjera, ekziston një ndarje e qartë e sferës laike dhe asaj shpirtërore në gadishull. Për sferën shpirtërore dhe marrëdhëniet ndërmjet manastireve dhe murgjve janë përgjegjëse institucionet e Malit Athos (në lëmin e pushtetit legjislativ dhe atij gjyqësor) dhe Patriarkana Ekumenike, ndërsa guvernatori mbikëqyr zbatimin dhe për këtë e informon Ministrinë e Punëve të Jashtme.<sup>55</sup> Për sferën laike, me rolin shtesë të institucioneve të Malit Athos, është përgjegjës shteti përmes personit të guvernatorit dhe zëvendësit të tij, gjykatave jashtë Malit Athos dhe policisë.

Institucionet e Malit të Shenjtë (Athos) janë:

1. Komuna e Shenjtë (Protoda e shenjtë): organi që e administron Malin e Shenjtë, merr vendime të cilave janë të detyruara t'u përmbahen të gjitha manastiret. Përbëhet nga një

<sup>52</sup> Kushtetuta e Republikës së Greqisë, neni 105. i lidhur me nenin e dikurshëm 104. Kushtetutën e vitit 1927.

<sup>53</sup> Për listën e manastireve, me datat e themelimit shih: "Mount Athos – The Ecumenical Patriarchate." Home – The Ecumenical Patriarchate, gjendet në <https://bit.ly/2WfQfSG>, e parë për herë të fundit më 8 maj 2020.

<sup>54</sup> Kushtetuta e Republikës së Greqisë, neni 105

<sup>55</sup> Leanza, Umberto. *op.cit*, 46



përfaqësues nga secili manastir, të cilët zgjedhen çdo vit. Komuna e shenjtë në të njëjtën kohë është gjykatë e shkallës së dytë. Ky institucion mblidhet rregullisht tre herë në javë;

2. **Epistaza e Shenjtë** – organi ekzekutiv i Komunës së Shenjtë, dhe përbëhet nga 4 përfaqësues (manastiret ndahen në 5 grupe, nga një anëtar vjen nga secili grup). Epistaza e shenjtë udhëhiqet nga protoepistati, përkatësisht kryetari. Epistaza kujdeset për ekzekutimin e vendimeve të Komunës së Shenjtë, kryen funksionin e drejtorisë së policisë dhe gjykatës së shkallës së parë për kundërvajtje (si për murgjit, ashtu edhe për njerëzit laikë), kujdeset për çështjet për të cilat përndryshe janë përgjegjëse komunat (pastërtia dhe mbikëqyrja sanitare, gjendja e rrugëve, ndriçimi, etj.), dhe mbikëqyr rendin dhe moralin publik në Karejë dhe në dokun Dafni.<sup>56</sup> Nën komandën e tij ai e ka edhe departamentin e vet të „policisë“ që mbikëqyr rendin dhe qetësinë publike, ndërsa mund të kërkojë edhe ndërhyrjen e policisë greke;
3. **Këshilli i Shenjtë (sinaksis)** – mblidhet dy herë në vit, dhe përbëhet nga përfaqësues të manastireve në Malin e Shenjtë (abatët ose pro-abatët), dhe merr vendime kanonike. Vendimet që prekin çështjet laike konfirmohen nga Ministri i Punëve të Jashtme, ndërsa Patriarku Ekumenik është përgjegjës për konfirmimin e çështjeve shpirtërore, të dy këto pa të drejtën për të bërë ndryshime.<sup>57</sup>

Siç e kemi parë tashmë, Mali i Shenjtë gëzon autonomi gjyqësore në fusha të caktuara, dhe institucionet që kryejnë detyrën e gjykatave janë eprorë të manastirit, Komuna e Shenjtë, Epistaza e Shenjtë dhe në fund Patriarku Ekumenik. Shkeljet e rënda dhe veprat penale procedohen në gjykatat shtetërore, me detyrimin që procedura hetimore të kryhet në Malin e Shenjtë, në bashkëpunim me Epistazën e Shenjtë. Shkeljet penale nga e drejta penale e përgjithshme, si dhe kundërvajtjet e tregut dhe të tjera të kryera nga murgjit dhe njerëzit laikë procedohen nga gjykatat e Malit Athos. Të gjitha shkeljet kanonike procedohen nga gjykatat e Malit Athos, d.m.th. Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike

Gjithashtu, përveç vetëqeverisjes, Mali Athos gëzon një sërë privilegjesh shpirtërore, financiare dhe të veçanta, prej të cilave më të rëndësishmet janë:<sup>58</sup>

- Në territorin e Malit Athos në masë të madhe nuk zbatohet kuadri ligjor i BE-së, gjë që është e bazuar në Deklaratën e Përbashkët Nr. 4 e cila është pjesë përbërëse e Dokumentit Përfundimtar të vitit 1981 mbi pranimin e Greqisë në Bashkimin Evropian;
- Mali Athos gëzon privilegje të shumta financiare, vëllimi i të cilave përcaktohet nga parlamenti grek.
- Toka u përket plotësisht manastireve të Malit Athos dhe nuk mund të shpronësohet;

<sup>56</sup> Menaxhimi i Malit të Shenjtë (Athos) sot, gjendet në <https://bit.ly/2LcFev2>, i parë për herë të fundit më 8 maj 2020.

<sup>57</sup> Папастатис, Хараламбос К. “Савремени Правни Статус Свете Горе.” *Зборник Радова Византолошког Института* XLI (2004): 530.

<sup>58</sup> Папастатис, Хараламбос К. “Савремени Правни Статус Свете Горе.” *Зборник Радова Византолошког Института* XLI (2004): 531-536.

- Ekzistojnë kufizime sa i përket vendosjes në Malin e Shenjtë: murgjit dhe rishtarët (që duan të dorëzohen si murgj) e që u përkasin manastireve të Malit Athos duhet të jenë ortodoksë dhe nuk mund të largohen nga Athosi pa leje me shkrim; personat që dëshirojnë ta vizitojnë Malin e Shenjtë duhet të marrin leje nga zyrat e Epistazës së Shenjtë në Selanik ose Ouranopoli; personave të gjinisë femërore u ndalohet të hyjnë në Malin e Shenjtë; laikët mund të marrin leje qëndrimi të përhershme për arsye profesionale, nëse kjo miratohet nga institucionet e Malit Athos; të huajt që bëhen rishtarë, bëhen murgj ose murgjit që transferohen në një nga manastiret në Malin Athos automatikisht e marrin shtetësinë greke, etj.<sup>59</sup>
- Ndalohet shitja e pasurive të paluajtshme, por lejohet vetëm shkëmbimi ndërmjet manastireve. Manastiret janë përgjegjëse për të mbrojtur thesaret e manastirit;
- Tregtia është e ndaluar, përveç se me sendet e nevojshme për jetën e tërë mjedisit, përveç në Karejë dhe Dafne,
- Nuk lejohet krijimi i shoqatave;
- Ndalohet çdo lloj përpjekje për konvertim ose propagandë.

## Qyteti i Vatikanit

Shteti i Vatikanit është një shembull dukshëm më i ndryshëm nga Athosi, por në thelb edhe ky është subjekt kishtarë. Vatikani gëzon pavarësi dhe shtetësi në një territor të caktuar kompakt, dhe gjithashtu zotëron pronë që gëzon të drejta të eksterritorialitetit në territorin e qytetit të Romës, si dhe jashtë tij. Qyteti i Vatikanit u krijua nga Traktati Lateran i vitit 1929, me të cilin u zgjidh problemi i krijuar nga bashkimi i mbetjeve të shtetit papal ose rajonit të Lacios me qytetin e Romës me Mbretërinë e Bashkuar të Italisë në 1870. Atëherë Papa e deklaroi veten të burgosur në Vatikan dhe mori një qëndrim shumë armiqësor ndaj shtetit të ri italian. Traktati Lateran krijoi një shtet të pavarur dhe sovran, Qyteti i Vatikanit, territori i të cilit shtrihet në më pak se gjysmë kilometri katror, përfshirë Kishën e Shën Pjetrit, sheshin, si dhe godinat dhe tokën në afërsi të menjëhershme. Me këtë u njoh nevoja që selia e Selisë së Shenjtë, si qendra e Kishës Katolike Romane në botë, të jetë në një shtet të pavarur. Këtu do të shqyrtojmë vetëm elementet e përfshira në pjesën e parë të Traktatit, Marrëveshjen e pajtimit, e cila përbëhet nga 27 pika, ndërsa analiza nuk do të përfshijë dy pjesët e tjera: Konventën Financiare dhe Konkordatin.

Me Traktatin Lateran u krijua Shteti i Vatikanit dhe u rregulluan marrëdhëniet ndërmjet shtetit të Italisë dhe Selisë së Shenjtë:

- U krijua shteti i pavarur dhe sovran, Qyteti i Vatikanit, i cili është pronë e plotë, sundimi ekskluziv dhe absolut i Selisë së Shenjtë, e cila gëzon sovranitet të plotë mbi të.<sup>60</sup> Italia e ka njohur sovranitetin e plotë të Selisë së Shenjtë në çështjet ndërkombëtare, në pajtim

<sup>59</sup>Kushtetuta e Republikës së Greqisë, neni 105

<sup>60</sup> Traktati Lateran, Preambula dhe neni 3



me traditat dhe veprimtaritë e kishës jashtë vendit.<sup>61</sup> Në të njëjtën kohë, Katolicizmi Roman njihet si feja e vetme shtetërore në Itali,<sup>62</sup>

- Selia e Shenjtë gëzon sovranitet dhe juridiksion të plotë mbi Qytetin e Vatikanit, dhe qeverisë italiane i ndalohet të ndërhyjë në çfarëdo rasti;<sup>63</sup>
- Sheshi i Shën Pjetrit mbetet i hapur për publikun dhe policia italiane është përgjegjëse për rendin dhe qetësinë publike (përveç në rastin e ceremonive speciale), juridiksioni i të cilës përfundon në Kishën e Shën Pjetrit (përveç në rast të një kërkesë nga vetë Selia e Shenjtë), e cila, megjithatë, mbetet gjithashtu e hapur për publikun;<sup>64</sup>
- Italia obligohet që t'i sigurojë Qytetit të Vatikanit: lidhjen me shërbimet publike komunale, si dhe lidhjen hekurudhore; lidhjet telegrafike, telefonike dhe postare. Me një marrëveshje të veçantë është e rregulluar lëvizja e automjeteve rrugore dhe e aeroplanëve të Vatikanit nëpër territorin italian.<sup>65</sup> Është e ndaluar që aeroplanët të fluturojnë mbi territorin e Qytetit të Vatikanit (neni 7);<sup>66</sup>
- Të gjithë personat që kanë qëndrim të përhershëm në territorin e Qytetit të Vatikanit janë nën sovranitetin e Selisë së Shenjtë, dhe në rast se statusi i tyre ndryshon, dhe ata nuk kanë ndonjë shtetësi tjetër, ata trajtohen si shtetas italianë. Personat që janë subjekt i sovranitetit të Selisë së Shenjtë u nënshtrohen ligjeve italiane në territorin e Italisë, ndërsa në rastin e shtetasve të huaj, ligji i vendeve prej nga vijnë ata.<sup>67</sup> Të gjithë punonjësit e Selisë së Shenjtë në territorin e Italisë do të trajtohen si shtetas italianë. Të gjithë ata, si dhe persona laikë të punësuar në Qytetin e Vatikanit, të cilët konsiderohen të domosdoshëm, lirohen nga shërbimi ushtarak, shërbimi në juri dhe detyrimet e tjera të një natyre personale. Kardinalët që jetojnë përherë në Romë trajtohen si qytetarë.<sup>68</sup> I njëjti nen përcakton që kishat, detyra e të cilave është që pa Vatikanin të marrin pjesë në ekzekutimin e akteve që burojnë nga Selia e Shenjtë, nuk do t'u nënshtrohen kurrfarë pengesave, hetimeve ose keqtrajttimeve nga ana e autoriteteve italiane;
- Italia nuk do të përzihet në punën e organeve qendrore të Kishës Katolike Romane, përveç se në çështjen e bartjes së titujve të pasurive të paluajshme;<sup>69</sup>
- Situata është e rregulluar në rast se të dyshuarit në të dy vendet ikin në territorin e tjetrës, pra detyrimi për ekstradim, si dhe mundësia që Selia e Shenjtë ta thërrasë Italinë për ndihmë në rast të veprave të kryera në territorin e Qytetit të Vatikanit;<sup>70</sup>
- Të gjitha përfaqësitë diplomatike në Selinë e Shenjtë, edhe nëse ndodhen në territorin e Italisë, do të trajtohen në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe do të gëzojnë imunitet;

---

<sup>61</sup> Po aty, neni 2

<sup>62</sup> Ky nen më vonë është lënë përmes Marrëveshjes plotësuese të vitit 1984

<sup>63</sup> Po aty, neni 4

<sup>64</sup> Po aty, neni 3

<sup>65</sup> Po aty, neni 6

<sup>66</sup> Po aty, neni 7

<sup>67</sup> Po aty, neni 9

<sup>68</sup> Po aty, neni 21

<sup>69</sup> Po aty, neni 11

<sup>70</sup> Po aty, neni 22

- Qeveria e Italisë kujdeset që të ndalojë çfarëdo ndërtimi në territorin përreth Qytetit të Vatikanit dhe angazhohet për prishjen e disa godinave ekzistuese në ato vende;<sup>71</sup>
- Nenet 13, 14 dhe 15 i definojnë pronat eksterritoriale të Selisë së Shenjtë në Romë dhe jashtë saj: Bazilika e Shën Gjon Laterani, Shën Maria Maggiore, dhe Shën Pali jashtë mureve, Pallati Papnor në Castel Gondolfo (jashtë Romës), Pallati Lateran, Universiteti Lateran, Shkallët e Shenjta, Pallati i Shën Callistus, Pallati i Zyrës Papnore, Pallati i Kongregacionit për Përhapjen e Besimit, Pallati i Zyrës së Shenjtë, Pallati i Kongregatës për Kishat Orientale, etj. Po ashtu, në posedimin e Selisë së Shenjtë, pa të drejtën e eksterritorialitetit janë disa prona të tjera brenda dhe jashtë Romës;
- Neni 21 në mënyrë plotësuese e definon situatën në rast se pozicioni i Papës është i lirë, si dhe dispozita speciale në lidhje me mbledhjen e Konklavës dhe obligimet e shtetit italian për të mundësuar një seancë të papenguar të Konklavës;
- U shpall neutraliteti i qartë i Qytetit të Vatikanit në marrëdhëniet ndërkombëtare.<sup>72</sup>

Duhet të kihet parasysh se Marrëveshja Themelore ndërmjet Selisë së Shenjtë dhe Izraelit, d.m.th konkordati i vitit 1993, parasheh një lloj sovraniteti në praktikë të Kishës Katolike Romane mbi disa nga vendet e shenjta të krishtera në Izrael.<sup>73</sup>

## Paralelet

Megjithëse ndoshta asnjë nga këta dy shembuj nuk mund të merret si model, kryesisht sepse në të dyja rastet baza është ekzistenca e një territori kompakt, që nuk është rasti me trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë, ekzistojnë disa paralele që mund të jenë të dobishme në rastin e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në territorin e Kosovës:

- Shembulli i Malit të Shenjtë tregon se është e mundur të ekzistojë një autoritet suprem shpirtëror mbi territorin autonom, selia e të cilit është jashtë vendit amë. Gjersa Mali i Shenjtë është i ndarë nga sistemi i kishës në pjesën tjetër të Greqisë dhe është në varësi të drejtpërdrejt të Patriarkut Ekumenik në Stamboll, Vatikani është qendra ndërkombëtare e Kishës Katolike Romane, dhe në të njëjtën kohë autoriteti laik mbi Qytetin e Vatikanit dhe pronat eksterritoriale, dhe autoriteti shpirtëror mbi Kishën Katolike Romane në të gjithë Italinë;
- Si Mali i Shenjtë, ashtu edhe Qyteti i Vatikanit i përcaktojnë mënyrat në të cilat të huajt, të cilët janë murgj, anëtarë të klerit ose punonjës në kisha/manastire, e rregullojnë statusin e tyre në lidhje me shtetin që i rrethon (Vatikanin) ose pjesë e të cilët ata janë (Mali i Shenjtë);
- Gjersa Qyteti i Vatikanit ka një gjyqësor plotësisht të pavarur dhe sovranitet të plotë, Mali i Shenjtë ka një autonomi legjislativë në lidhje me çështje shpirtërore, si dhe

---

<sup>71</sup> Po aty, neni 7

<sup>72</sup> Po aty, neni 24

<sup>73</sup> Leanza, Umberto. *op.cit*, 42

autonomi gjyqësore mbi monastizmin dhe pjesërisht mbi laikët, ndërsa Greqia ka juridiksion për veprat e rënda penale;

- Përveç sovranitetit të saj mbi Qytetin e Vatikanit, Selia e Shenjtë zotëron gjithashtu një numër të pronash ekstraterritoriale brenda dhe jashtë qytetit të Romës, të cilat nuk janë të lidhura territorialisht me Vatikanin, si dhe disa prona që nuk kanë status ekstraterritorial;
- Në Malin e Shenjtë ndalohet shitja e pasurive të patundshme, në Vatikan konvertimi i tyre nuk lejohet pa pëlqimin e Italisë, ndërsa Italia gjithashtu është e detyruar të sigurojë ndalimin e ndërtimeve të reja në pjesët e Romës që e rrethojnë Vatikanin;
- Pjesët publike të Qytetit të Vatikanit, si dhe pronat eksterritoriale dhe pronat e Selisë së Shenjtë, janë integruar në mjedisin e tyre, d.m.th Romë dhe qytete të tjera. Me fjalë të tjera, ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë me mjedisin e afërt;
- Definohet detyrimi i Italisë për t'i siguruar Vatikanit lidhjet e komunikimit, si dhe lidhjen me instalimet e qytetit;
- Si Qyteti i Vatikanit, edhe ai i Malit të Shenjtë (Athos) janë të përfshira në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

## **SHEMBUJT E ZGJIDHJEVE TERRITORIALE PËR NJËSITË MË TË VOGLA**

### **Enklavat**

Opsioni i parë që është i mundur si përgjigje territoriale në çështjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, si dhe në funksionimin e ardhshëm të KOS-it në territorin e Kosovës, janë enklavat, përkatësisht esklavat. Këto dy terme, që në thelb nënkuptojnë të njëjtën gjë - territorin ose një pjesë të territorit të një shteti të rrethuar nga territori i një shteti tjetër (në rastin e enklavave dhe esklavave) ose shteteve të tjera (në rastin e esklavave). Po ashtu, ekzistojnë enklava/esklava të brendshme brenda shteteve me nivele të ndryshme qeverisjeje, me enklavat/esklavat e brendshme. Në çdo rast, enklavat/esklavat ekzistojnë si njësi të ndara të shtetit amë (përveç në rastet kur enklavat janë vetë shteti), ku zbatohet korniza ligjore e shteteve amë, zakonisht me zgjidhje specifike që e lehtësojnë jetën e përditshme për popullatën që jeton në to. Me fjalë të tjera, mund të ketë përjashtime ose stimuj të veçantë nga ana e shtetit amë për qytetarët që jetojnë në enklava/esklava: p.sh. ulja e taksave, përfitimet doganore, etj. Shpesh ka marrëveshje me shtetet që i rrethojnë enklavat/esklavat, për të mundësuar funksionim më të mirë në praktikë, siç janë kalimet kufitare ose ndërtimi i lidhjeve rrugore/hekurudhore që e lidh enklavën/esklavën me territorin e amë (rasti i të ashtuquajturave pene-enklava).

Enklavat/esklavat nuk janë dukuri e rrallë, siç duket në shikim të parë. Shembulli i përmendur më parë i Vatikanit është saktësisht shembulli i një enklave që është në të njëjtën kohë edhe shtet. I njëjtë është rasti me një tjetër mikro-shtet që rrethohet nga Italia, San Marino. Esklavat/enklavat janë relativisht të shpeshta edhe në Evropë. Për shembull, Republika Autonome e Nakhichevan-it është një esklavë e Azerbajxhanit që rrethohet nga Armenia, Turqia dhe Irani, me rreth 400 mijë banorë dhe një territor prej 5500 km. Baarle-Hertog është një komunë belge e përbërë nga 22 enklava/esklava të vogla brenda territorit të Holandës, ndërsa brenda disa prej enklavave/esklavave belge ka 6 (kundër) enklava holandeze të cilat i përkasin komunës së BarleNassau. Shumica e qytetarëve që jetojnë në këto enklava/esklava kanë shtetësi edhe holandeze, e edhe belge.<sup>74</sup> Esklava më e madhe në Evropë është Rajoni i Kaliningradit, ai është një pjesë integrale e Federatës Ruse, dhe rrethohet nga Polonia dhe Lituania, por meqenëse ka dalje në det, ai më shumë definohet si një gjysmë-esklavë. Rajoni i Kaliningradit ka pak më pak se një milion banorë, ndërsa madhësia e tij përfshin 15 mijë kilometra katrorë. Nga ato më të rëndësishmet në Evropë, ekzistojnë disa enklava/esklava të tjera të Spanjës, Italisë, Rusisë, Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë.

Ndoshta enklava/esklava më e famshme historike është Berlina Perëndimor, i cili i përkiste Gjermanisë Perëndimore edhe pse plotësisht i rrethuar nga Gjermania Lindore, ndërsa në një moment ishte i lidhur me një autostradë të mbyllur me vendin amë.

---

<sup>74</sup> Eames, Andrew. "Travel - Europe's Strange Border Anomaly." BBC, 11. decembar 2017.g., gjendet në <https://bbc.in/2xLvULJ>, e parë së fundmi më 8. maj 2020.g.

Aktualisht në Ballkan ekzistojnë dy enklava/esklava. Fshati Sastavci, me rreth 1.400 banorë, i përket komunës Rudo në Bosnjë dhe Hercegovinë, por është i rrethuar plotësisht nga komuna e Pribojit në Serbi. Brezovica Žumberačka është pjesë e fshatit Brezovica në Metlika, por në aspektin juridik është një esklavë/enklavë kroate në Slloveni, e cila ka rreth 30 banorë.<sup>75</sup>

Siç mund të shihet, enklavat nuk janë zgjidhje aq të pazakonshme si zgjidhje territoriale për çështjet e kontestueshme, megjithëse ato potencialisht sjellin me vete një mori sfidash. Sidoqoftë, në kontekstin e çështjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare serbe, mund të dëshmohet se është një zgjidhje interesante për manastiret dhe kishat më të rëndësishme, natyrisht duke gjetur një model adekuat për integrimin me mjedisin e afërt, hapjen dhe sigurinë (në secilin kuptim), si dhe aranzhimet e tjera të drejtpërdrejta të cilat janë të nevojshme. Me aplikimin e kësaj qasjeje, Serbia mund të mbetet titullar i trashëgimisë së regjistruar në listën e UNESCO-s, nëse marrëveshja gjithëpërfshirëse do të nënkuptonte edhe ulësen për Prishtinën në Kombet e Bashkuara dhe organizatat e tjera ndërkombëtare.

### **Eksterritorialiteti (si koncept territorial) dhe territori që është në pronësi të subjektit tjetër**

Ekstraterritorialiteti (në kuptimin territorial) është koncept që më së shpeshti ndërlidhet me përfaqësitë diplomatike, zakonisht duke shënuar pjesën e territorit ku nuk zbatohen ligjet e vendit pritës, dhe i cili drejtohet nga një shtet tjetër. Me fjalë të tjera, shteti pritës mban të gjitha të drejtat sovrane mbi territorin mbi të cilin aplikohet ekstraterritorialiteti, por që kuadri i tij legjislativ nuk zbatohet. Përveç përfaqësive diplomatike, ekstraterritorialiteti është zgjidhje që vlen edhe për selinë dhe përfaqësitë e organizatave ndërkombëtare, të tilla si selia e OKB-së në New York dhe Gjenevë, dhe selia e NATO-s në Bruksel. Kemi parë gjithashtu shembuj që Qyteti i Vatikanit ka një gamë të tërë të zotërimeve ekstraterritoriale në qytetin e Romës dhe në Itali, të cilat janë edhe më të mëdha se vetë Vatikanin (vetë Pallati Pontifikal në Castel Gandolfo është pak më i madh se territori i Qytetit të Vatikanit). Ndoshta shembulli më interesant i ekstraterritorialitetit, që kufizohet me shembullin e kondominiumit (që do të shqyrtojmë më vonë), është selia e Urdhrit të Kalorësve të Maltës, d.m.th. Urdhrit i Spitalit Ushtarak Sovran të Shën Gjjonit të Jerusalemit i Rodosit dhe i Maltës, i cili njihet si subjekt sovran sipas të drejtës ndërkombëtare, por që nuk ka territorin e vet. Gjatë rivendosjes së urdhrit më 1834,<sup>76</sup> u vendos qendra e re e urdhrit në Romë, në Pallatin e Maltës, të cilit në vitin 1869 i është dhënë ekstraterritorialiteti nga ana e shtetit papnor. Shteti italian gjithashtu e njeh ekstraterritorialitetin e Pallatit të Maltës (si dhe të vilave të Maltës), por edhe e drejta që urdhri në selinë e vet të gëzojë sovranitetin që bashkë-ekziston në të njëjtën kohë me atë italian.<sup>77</sup> Në vitin 2001, Malta i dha Urdhrit të drejtën e shfrytëzimit të pjesës së epërme të Kalasë së Shën

<sup>75</sup> Jan S. Krogh's Geosite: Brezovica, gjendet në <https://bit.ly/2zj68Pe>, e parë për herë të fundit më 8 maj 2020.

<sup>76</sup> Urdhri është hequr pas pushtimit të Maltës nga Napoleoni në 1798.

<sup>77</sup> Klieger, P. Christiaan. *The Microstates of Europe: Designer Nations in a Post-Modern World*. Lexington Books, 2012. 95-96

Angelo në qytetin e Birgu për 99 vjet, me ekstraterritorialitet të kufizuar. Kjo kala ka qenë selia e Urdhrit, gjatë kohës së kontrollit të tyre të Maltës prej 1530 deri në 1798.<sup>78</sup>

Gjithashtu, subjektet e tjera sovrane mund të kenë të drejtë kontrolli në aspekte të caktuara mbi njësi të caktuara mikro-territoriale ose godina, megjithatë ato prapëseprapë bien nën sovranitetin e vendit pritës: siç janë varrezat e rëndësishme, kishat, kështjellat, etj. Gjithashtu në rastin e Qytetit të Vatikanit, ekzistojnë disa kisha në territorin e Italisë, të cilat janë pronë e Selisë së Shenjtë, por pa të drejtën e ekstraterritorialitetit.

Ekstraterritorialiteti mund të jetë zgjidhja për çështjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, por në këtë rast titullare e pronës do të ishte Prishtina, gjë që me siguri nuk do të ishte e pranueshme për KOS-in ose Beogradin.

### Sovraniteti i dyfishtë– kondominium

Më në fund, vijmë në shembullin e fundit të situatës juridike që do të mund të jetë me interes për zgjidhjen e çështjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë – kondominiumi ose sovraniteti i dyfishtë mbi një territor të caktuar. Në histori, kemi shembuj kur modelit të kondominiumit i kthehem kur ekzistojnë mosmarrëveshje për çështjet e kufijve dhe kur përpjekjet e tjera kryesisht kanë dështuar.<sup>79</sup> Ky model mundëson që me sovranitet/juridiksion të përbashkët të definohen mekanizmat e qeverisjes në atë mënyrë që të gjitha palët formalisht të jenë të kënaqura. Kondominiumet nuk janë të shpeshta, para së gjithash për shkak se shtetet nuk janë shumë të gatshme të ndajnë sovranitetin, por ato mund të jenë një zgjidhje afatgjatë për mosmarrëveshje të rënda për kufijtë.<sup>80</sup> Në shumicën e rasteve, kondominiumet e sotme kryesisht kanë të bëjnë me territoret e pabanuara ose sipërfaqet ujore, mbi të cilat palët në marrëveshje e ndajnë sovranitetin, siç është ishulli i Fazanit në lumin Bidasoa, i cili është një kondominium i Francës dhe i Spanjës, ose pjesë të lumit Parana, të cilat janë një kondominium ndërmjet Brazilit dhe Paraguajit në Amerikën Jugore.

Megjithatë, në disa raste, në pyetje janë edhe territore të banuara. Për ne, rasti më i njohur i një kondominiumi është kondominiumi i brendshëm në kuadër të Bosnje dhe Hercegovinës, distrikti i Brčko-s, i cili njëkohësisht është pjesë e të dy entiteteve, Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës dhe i Republikës Srpska. Pas vitit 2006, mbikëqyrësi ndërkombëtar i distriktit i dha fund përdorimit të ligjeve të entitetit, si dhe ekzistencës së kufijve ndërmjet entiteteve brenda vetë distriktit, dhe deklaroi se distrikti mbështetej në ligjet e veta, si dhe në ligjet e

---

<sup>78</sup>Cahoon, Ben, *Sovereign Military Order of Malta*, gjendet në <https://bit.ly/35Ibdg>, e parë së fundmi më 8. maj 2020.g.

<sup>79</sup>Samuels, Joel H. "Condominium Arrangements in International Practice: Reviving an Abandoned Concept of Boundary Dispute Resolution." *Michigan Journal of International Law*. 2008, 29 (4), p. 738.

<sup>80</sup>Po aty.

Bosnjës dhe Hercegovinës.<sup>81</sup> Me fjalë të tjera, zyrtarisht distrikti është pjesë e të dy entiteteve, por në praktikë funksionon si një tërësi autonome brenda Bosnje dhe Hercegovinës.

Sa i përket kondominiumeve historike, duhet të cekem disa shembuj:

1. Kondominiumi i Britanisë së Madhe dhe Francës mbi koloninë e New Hybrides, i vendosur në vitin 1906, dhe që u shfuqizua në vitin 1980 kur New Hybrides u bënë një shtet i pavarur i Vanuatu-s. Kondominiumi funksiononte në atë mënyrë që shtetasit e Francës dhe ata të Britanisë së Madhe ishin nën juridiksionin e shteteve amë, ndërsa ata së bashku menaxhonin me popullsinë lokale, përmes institucioneve të përbashkëta lokale, përfshirë edhe gjykatën.<sup>82</sup> Shpenzimet e pjesës së tyre të administratës financoheshin nga secili prej sovranëve, ndërsa të ardhurat lokale shkonin në fondin<sup>83</sup> e përbashkët të kondominiumit.
2. Kondominiumi Schleswig-Holstein - Pasi Prusia dhe Austria e mposhtën Danimarkën në luftën rreth Schleswig-Holstein në vitin 1864, Danimarka ia dorëzoi të dy këto krahina, administratës së përbashkët të Austrisë dhe Prusisë. Kondominiumi mbi këto dy krahina ishte i organizuar në atë mënyrë që Holsteini qeverisej nga Austria, ndërsa Schleswig qeverisej nga Prusia, ndërsa sovraniteti formalisht ishte i përbashkët. Pas luftës ndërmjet Austrisë dhe Prusisë në vitin 1866, Austria i lëshoi të drejtat mbi Schleswig-Holstein.
3. Kondominiumi i Sudanit: Formalisht Sudani ishte kondominium i Britanisë së Madhe dhe Egjiptit në periudhën 1899-1956. Megjithatë, përveç flamurit dhe ndikimit të kufizuar lokal, Egjipti në praktikë nuk mori pjesë në menaxhimin dhe kontrollin e Sudanit, dhe kryesisht gjithçka u lihej zyrtarëve britanikë.

Këta shembuj tregojnë se kondominiumet mund të funksionojnë në praktikë, por gjithashtu që nëse territori është i banuar, ato duhet të bëhen institucione vendore që sigurojnë menaxhim autonom lokal, ndërsa territori në fjalë mbetet nën sovranitetin e përbashkët të të dyja palëve. Po ashtu, shembulli i Brčko-s tregon se kondominiumet mund të ekzistojnë edhe brenda një shteti.

Sigurisht, nëse një marrëveshje e mundshme gjithëpërfshirëse do të nënkuptonte edhe ulëse në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare për Prishtinën, do të duhej të gjendej një zgjidhje adekuate në lidhje me përfaqësimin në UNESCO.

---

<sup>81</sup> Urdhri i mbikëqyrësit me të cilin shfuqizohen ligjet e entiteteve në rajonin e Distriktit Brčko dhe shpallet ndërprerja e fuqisë juridike të kufirit ndërmjet entiteteve në Distrikt, 2006, në dispozicion në <https://bit.ly/2zj6rJS>, e parë së fundmi më 8 maj 2020.

<sup>82</sup> Samuels, Joel H. *op.cit.* 738.

<sup>83</sup> Po aty



## PËRFUNDIM – GAMA E REALIZIMIT TË KUADRIT NORMATIV PËR TRASHËGIMINË FETARE DHE KULTURORE SERBE NË KOSOVË

Përmes zbatimit të planit të Ahtisaarit, në kuadër të kornizës ligjore normative, Kosova ka siguruar një nivel të lartë mbrojtjeje për trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe. Megjithatë, garancitë ligjore në periudhën pas konfliktit nuk çuan në ndërtimin e besimit ndëretnik dhe krijimin e parakushteve për pajtim. Në kuptimin politik, motivi themelor për miratimin e të gjitha ligjeve të përmendura ishte plotësimi i kushteve për përfundimin e pavarësisë së mbikëqyrur. Përveç kornizës së kërcënimit, justifikimi për miratimin e propozimeve legjislative nga udhëheqësit e Kosovës ishte korniza e pavarësisë, përkatësisht pasojat e mundshme negative për pozicionin ndërkombëtar të legjitimitetit të shtetësisë.<sup>84</sup> Për këtë arsye, nuk është ofruar mundësia që me dialog të vërtetë ndëretnik të pranoheshin objektet fetare dhe kulturore serbe si trashëgimi e komunitetit pakicë që është pjesë me të drejta të plota e shoqërisë kosovare.

Rrezikimi i sigurisë së objekteve ortodokse si dhe mosrespektimi i Ligjit për zonat e veçanta të mbrojtura nga autoritetet lokale kanë krijuar një hendek disavjeçarë ndërmjet normave të përcaktuara dhe zbatimit të tyre në praktikë. Në procesin e monitorimit të zbatimit të këtij ligji, Misioni i OSBE-së në Kosovë nxori në pah disa probleme dhe sfida në ruajtjen e trashëgimisë kulturore serbe. Para së gjithash, korniza ligjore është e paqartë në disa detaje, veçanërisht në ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet institucioneve kompetente për trashëgiminë kulturore. Kombinimi i kapaciteteve të kufizuara dhe mungesa e vullnetit politik e bëri të pamundur përfshirjen e trashëgimisë kulturore në planet hapësinore lokale dhe mbrojtjen e plotë kundër ndërtimeve pa leje.<sup>85</sup>

Trashëgimia kulturore dhe fetare serbe nuk ishte tema e dialogut në Bruksel, as nuk u përmend si një pikë në hapjen e Kapitullit 35 në negociatat për praninë të Serbisë me BE-në. Sidoqoftë, me aplikimin e dështuar të Kosovës për anëtarësim në UNESCO në vitin 2015, çështja e statusit të trashëgimisë kulturore mbetet e hapur, por ka të ngjarë të gjendet si pikë në marrëveshjen përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve.

Në procesin e dialogut deri më tani, fokusi ka qenë në integrimin e veriut të Kosovës në institucionet e Prishtinës dhe sigurimin e një lloji autonomie për komunitetin serb përmes Bashkësisë/Asociacionit të Komunave Serbe. Megjithatë, „normalizimi“ është riorientuar në zgjidhjet kreative. Për këtë arsye, analiza përmban edhe modele të zgjidhjeve territoriale për trashëgiminë, duke u nisur nga tri arsye: 1) modeli i enklavave/esklavave ose

<sup>84</sup>Lončar, Jelena, Cultural Heritage in Kosovo: Strengthening Exclusion through Inclusive Legislation, in: *Figuring out the Enemy: Re-Imagining Serbian-Albanian Relations*, edited by Aleksandar Pavlović, Adriana Zaharijević, Rigels Halili, and Draško Gazela Pudar, Belgrade, 2015, p. 419.

<sup>85</sup> OSBE, *“Sfidat në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të paluajshme në Kosovë”*, Prishtinë, 2014.



ekstraterritorialiteti që përmenden shumë shpesh në publik si model për statusin përfundimtar të trashëgimisë, posaçërisht pas votimit në UNESCO dhe drojës së Serbisë ndaj skenarit në të cilin manastiret në Kosovë nuk do të konsideroheshin më trashëgimi kulturore e saj; 2) objektet fetare dhe monumentet kulturore mbajnë me vete një kontigjent emocionesh identiteti që ndikojnë ndjeshëm në formimin e qëndrimeve të qytetarëve për marrëveshjen përfundimtare, pavarësisht nga mbizotërimi iluzorë i temave të tjera në kontestin sa i përket statusit; 3) pengimi i deritanishëm i zbatimit të akteve ligjore në fuqi në Kosovë (Ligji për zonat e veçanta të mbrojtura, Ligji për trashëgiminë kulturore dhe Ligji për lirinë e fesë) i forcon argumentet në favor të kornizës së re të statusit.

Aplikimi eventual i njërit prej tre modeleve: enklavat/esklavat, ekstraterritorialiteti ose kondominiumi nuk mund të përfshijë tërë trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe, por vetëm listën e atyre më të rëndësishmeve që do të definoheshin me një aneks të veçantë të marrëveshjes, ndërsa statusi i objekteve të tjera fetare dhe kulturore do të përfshihej nga një zgjidhje e veçantë ligjore në Kosovë, me një marrëdhënie kontraktuale ndërmjet KOS-it dhe autoriteteve në Prishtinë, si dhe i konfirmuar përmes një Marrëveshjeje të mundshme gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve. Në çdo rast, çfarëdo marrëveshje do të nënkuptonte obligimin e Beogradit dhe Prishtinës që të bashkëpunojnë në mënyrë përmbytësore për çështjen e vendeve të shenjta, të sigurojnë integrimin e vërtetë të trashëgimisë fetare dhe kulturore në mjedisin e afërt, si dhe të sigurojnë mbrojtje dhe siguri përmes një mekanizmi funksional të komunikimit dhe të bashkëpunimit.

## REKOMANDIMET

- Në vazhdimin e dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, është e nevojshme të hapet tema e pozitës dhe e statusit të ardhshëm të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë.
- Është e nevojshme t'i qasemi analizës gjithëpërfshirëse dhe profesionale të kornizës ligjore dhe zbatimit të ligjeve që ndërlidhen me mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, që do të çonte në formulimin e një zgjidhjeje të unifikuar ligjore;
- Përveç kornizës ekzistuese normative për trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe dhe ligjit të mundshëm të unifikuar, është e nevojshme të konfirmohen garancitë e statusit të veçantë në formën e marrëveshjeve ndërmjet KOS-it dhe autoriteteve në Prishtinë, si dhe ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës në kuadër të një marrëveshjeje të mundshme përfundimtare për normalizimin;
- Pavarësisht modelit të përdorur në definimin e statusit të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, është e nevojshme që KOS-i me qendër në Beograd, përkatësisht Dioqeza Rashkë - Prizren, autoriteti suprem i të cilit është Patriarku dhe Sinodi i Shenjtë i KOS-it të kenë administrim *de facto* dhe *de jure* mbi to;
- Përballë statusit përfundimtar, është e nevojshme të sigurohet që trashëgimia fetare dhe kulturore serbe të vazhdojë të arrijë integrimin shoqëror me mjedisin e afërt dhe popullatën shumicë që jeton në atë zonë, duke respektuar parimin e trashëgimisë kulturore si trashëgimi civilizuese pa marrë parasysh dallimet fetare dhe etnike;
- Në diskursin publik shoqëroro-politik, është e nevojshme që në Kosovë të shmangen interpretimet pseudo-historike, format e ndryshme të presionit dhe të kontestimit të të drejtave legjitime të KOS-it mbi trashëgiminë fetare dhe kulturore serbe në Kosovë;
- Parakusht për një marrëveshje afatgjatë është zgjidhja e të gjitha marrëdhënieve pasurore-juridike, e veçanërisht pronave që bien nën territorin e zonave të veçanta të mbrojtura, me qëllim të mbrojtjes së “identitetit historik dhe mjedisit natyror, duke përfshirë jetën monastike të klerit” të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe. Në këtë kuptim, është e nevojshme të shqyrtohet mundësia e shpronësimit të tokës në territorin e zonave të veçanta të mbrojtura, por edhe të fillohet procesi i kthimit të pronave KOS-it në Kosovë, siç parashikohet me planin e Ahtisaarit;
- Me rastin e definimit të statusit përfundimtar të trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, është e nevojshme të sigurohen garanci efektive për zbatimin brenda afateve të

përcaktuara kohore. Në këtë kuptim, janë të nevojshme garancitë dhe mekanizmat e sanksioneve nga aktorët ndërkombëtarë.



KONVENTA KOMBËTARE RRETH  
BASHKIMIT EVROPIAN  
KNEZA MILOŠA 4  
11000 BEOGRADI  
[WWW.EUKONVENT.ORG](http://WWW.EUKONVENT.ORG)  
[OFFICE@EUKONVENT.ORG](mailto:OFFICE@EUKONVENT.ORG)



INSTITUTI PËR ZHVILLIMIN  
EKONOMIK TERRITORIAL (INTER)  
VLJKOVIĆEVA 29  
11000 BEOGRADI  
+381 (0)11 3246 766  
[WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG](http://WWW.REGIONALNIRAZVOJ.ORG)  
[OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG](mailto:OFFICE@REGIONALNIRAZVOJ.ORG)